



University of Prizren Univerziteti Prizren "UKSHIN HOTI"	
Pranuar rre dt.	01.02.2022
Zyra e pranimit	Nr. i protokolit
308	01-12



## Memorandum Mirëkuptimi

Ndërmjet Universitetit "Ukshin Hoti" Prizren

Dhe

Asociation "Loyola-Gymnasium" (në tekstin e mëtejme ALG) Prizren,

bazuar në interesin e përbashkët për zhvillimin dhe përparimin e mësimdhënies-mësimnxënies në Universitetin "Ukshin Hoti" në Prizren dhe Asociation "Loyola-Gymnasium" në Prizren, por edhe zgjerimin e bashkëpunimit ndërmjet këtyre dy institucioneve,

Asociation "Loyola-Gymnasium", me adresë të përhershme në Prizren, adresa: Rruga e Tranzitit, p.n., Petrovë, 20000, Prizren, Kosovë, përfaqësuar nga Drejtori Ekzekutiv, Elias Koller.

ALG e cila ka kompetencë të marrë pjesë në shërbimet publike në fushën e arsimit fillor, të mesëm të ulët dhe të mesëm të lartë, si dhe vendosjen e marrëdhënieve me institucione të tjera akademike, kulturore dhe shkencore në Kosovë dhe jashtë saj

dhe

Universiteti "Ukshin Hoti" në Prizren, adresa "Rruga e Shkronjave", nr. 1, 20000, Prizren, Kosovë, e përfaqësuar nga Rektori, Prof. Asoc. Dr. Samedin Krrabaj. UPZ është universitet publik, i themeluar në vitin 2009 nga Qeveria e Republikës së Kosovës dhe me Statut të miratuar nga Kuvendi i Republikës së Kosovës, me vendimin nr. 04 -V-621.

### Dakordohen

për të nënshkruar një Marrëveshje Bashkëpunimi bazuar në pikat e mëposhtme:

Bashkëpunimi do të realizohet duke pasur si subjekt miratimin e UUHP dhe ALG për:

1. Vizitë (një javë - 10 orë mësimore) e studentëve të vitit të fundit të studimeve (kryesisht) në degën e Gjuhës dhe Letërsisë Gjermane dhe lëndëve të tjera të ofruara në të dyja institucionet.

- Një PK (Pikë kontakti) e caktuar nga UUHP përzgjedh studentët, bazuar në kriteret që diskutohen bashkërisht dhe përditësohen rregullisht ndërmjet institucioneve. Gjithashtu, një CV dhe një letër motivimi nga studentët e përzgjedhur paraprakisht kërkohet të dërgohen në ALG pas përzgjedhjes përfundimtare. Intervistat me kandidatët do të kryhen në bazë të diskrecionit.
- PK përgatit studentët, mban kontakte gjatë vëzhgimit dhe zhvillon një intervistë vlerësimi. Ai/ajo duhet të sigurojë kështu sigurimin e mundshëm të cilësisë.
- PK dhe personi përgjegjës në ALG duhet të shkëmbejnë informacione në baza të rregullta. Kjo duhet të inicohet në mënyrë proaktive nga PK.
- ALG u ofron studentëve mundësinë për të marrë pjesë në orët mësimore në mënyrë profesionale. Pjesëmarrja aktive është e detyrueshme. Konkretisht, kjo do të thotë: Të ndihmojnë në përgatitjet, të përgatisin dhe të shpërndajnë materiale mësimore, të ndihmojnë në mënyrë aktive gjatë orëve të mësimit nëse udhëzohen për ta bërë këtë, dhe të ndjekin mësimet nëse është e nevojshme. Sesionet e para mësimore aktive mund të jenë pjesë e vizitës brenda kufijve të rregullave në fuqi dhe mundësive të kandidatëve.
- ALG merr vendimin përfundimtar për kandidatët e parapërzgjedhur nga PK.

- f) ALG rezervon të drejtën të përjashtojë studentët nga praktika në rast mospërputhjeje me standardet dhe rregullat dhe në raste të tilla nuk do të lëshojë certifikata.
- g) Gjatë vizitës së studentëve, ALG është institucioni përgjegjës që merr përsipër të drejtat dhe përgjegjësitë për studentët. Gjatë kësaj kohe raportet duhet t'i jepen personit përgjegjës brenda ALG-së.
- h) Studentët fitojnë njohuri të vlefshme për mësimet e mbajtura në ALG. Ata shoqërohen dhe informohen nga pedagogët tanë të trajnuar dhe kanë mundësi të bëjnë pyetje në çdo kohë dhe në mënyrë aktive t'i vazhdojnë studimet e tyre.
- i) Studentët caktohen në mësimet nga ALG dhe marrin pjesë plotësisht në to.

Me këtë Memorandum Mirëkuptimi, dy institucionet konfirmojnë edhe mundësinë e zgjerimit të bashkëpunimit. Për shembull, në fushat e mëposhtme (dhe jo vetëm):

- Mundësi prezantimi të UUHP-së, të perspektivave të karrierës për nxënësit e ALG-së.
- Ftesa të mundshme reciproke për mësuesit në seminare, trajnime dhe ngjarje që lidhen me arsim dhe trajnim.
- Shkëmbimi i literaturës përkatëse profesionale dhe fondit nga bibliotekat. Zhvillim dhe shkëmbim i mëtejshëm mbi dixhitalizimin dhe katalogimin e bibliotekës.

II. Nënshkrimi i kësaj marrëveshjeje ndërmjet UUHP-së dhe ALG-së nuk nënkupton asnjë detyrim financiar.

III. Kjo marrëveshje është e vlefshme për një periudhë 1 (një) vjeçare nga data e nënshkrimit. Pas skadimit të kësaj date kjo marrëveshje mund të rinovohet në bazë të një marrëveshjeje të përbashkët me shkrim ose edhe të ndërpritet.

IV. Kjo marrëveshje mund të ndërpritet edhe para skadimit të afatit, nëse njëra palë nuk i plotëson kërkesat e marrëveshjes.

V. Kjo marrëveshje zbatohet me nënshkrimin e përfaqësuesve kompetentë ligjorë të të dyja institucioneve.

VI. Çdo ndryshim në këtë marrëveshje do të bëhet me shkrim dhe me njoftim reciprok dhe të menjëhershëm.

VII. Me nënshkrimin e kësaj marrëveshjeje automatikisht shpallen të pavlefshme të gjitha marrëveshjet e mëparshme dhe memorandumet e mirëkuptimit ndërmjet dy institucioneve.

VIII. Kjo marrëveshje është hartuar në dy (2) kopje në gjuhën shqipe.

Prizren, 01.02.2022

  
 Universiteti "Ukshin Hoti"  
 Prof. Asoc. Dr. Samedin Krraba  
 u.d. Rektor, Profesor i Asocuar



  
 Asociation "Loyola-Gymnasium"  
 Elias Koller  
 Drejtor Ekzekutiv

